

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Mbledhja e Radhes e Këshillit Bashkiak Muaji Prill mbajtur sot me datë 30/04/2026 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjese ne mbledhje nen/ Kryetari i Bashkise, z.Tajar Bici

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E.Zani: Pershendetje, duke uruar te jeni mire nisim mbledhjen. Citojme pikat e rendit te dites Votojme rendin e dites?

\*Miratohet rendi ditës me 11 Vota PRO.


Nuk ka Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani



Çështja 1

1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Mars 2026 (fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

Pergj.sek.ndh.ek.: Pershendetje, per muajin Mars 2026 jane gjeneruar nga sistemi elektronik i ndihmes ekonomike 44 familje gjithsej, ketu perfshihet edhe kompesimi i energjise per gjithë ato familje qe disponojne nje kontrate. Nese keni pyetje?

E.Zani: Kush e do fjalën Votojme?

\*Miratohet pika 1 e rendit të ditës me 11 Vota PRO

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani

Greta Lena

Enis Zani

Çështja 2

2- Mbi Planin Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në bashkinë Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

Pergj.ndh.ek: Ky plan eshte nje dokument strategjik i nevojshem, ky plan ka ne fokus 5 fusha kryesore:

1. arsimin dhe trashegimine kulturore
2. strehimin dhe infrastrukturen
3. punesimin dhe mbrojtjen sociale
4. shendetsine
5. perfshirjen sociale

Ky plan nuk ka ekzistuar me pare ne bashkine e Gramshit, na ka penguar te marrim mundesi financimi per kete komunitet. eshte nje dokument qe na duhet per te perthithur financime nga OJF te ndryshme.

F.Cekrezi: A mbahen fakte~prova per keto lloj sherbimi qe i duhen komunitetit?

Pergj.ndh.ek: Takime konsultative ka patur.

E.Zani: Pjesa e ketyre takimeve do te ishte mire te kishte pasur edhe anetare te keshillit, kjo pjese mbetet per tu permiresuar.

Pergj.ndh.ek: Sipas kerkeses se ekspertit une km bere te gjitha njoftimet.

D.Hazizaj: Te kishim ca te dhena statistika do te ishte mire.

Pergj.ndh.ek: Ky plan na duhet per perthithjen e fondeve te huaja.

E.Zani: Votojme?

\*Miratohet pika 2 e rendit te ditës me 11 Vota PRO

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani

### Çështja 3

### 3- Për miratimin e Rregullores për Procedurën e Vlerësimit të Performancës së Drejtuesve të Kopshteve.

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

**I. Basha:** Vlerësimi i performancës së drejtoreve bëhet nepermjet instrumentave që miratohen nga keshilli. Ministria e arsimit ka të drejtën e vlerësimit dhe ka anën kurrikulare, persa i përket menyrës se si menaxhohet, drejtohet dhe si harxhoen fondet, dhe gjithë veprimtaria, do të monitorohet nepermjet instrumentave që i keni bashkëngjitur rregullores.

**A. Hasa:** Performanca e drejtuesit është e gjithë puna gjatë 1 viti, nepermjet ketzre vlerësimeve e zgjeron ndjeshëm dhe përmirëson punën e drejtuesit.

**F. Cekrezi:** Kjo duhet të kalonte paraprakisht në Komisionin e Ligjeve. Të neni 10 keni detzrimet pastaj masat, si do i marrësh masat pa asur llojet. Lidhur me piken tjetër prevalon me parë kontrata kolektive (para rregullores) dhe ka 4 pika masash nënderkohe rregullorja ka 3 pika masash.

**A. Hasa:** Për të marrë atë masë mbledhet bordi me parë.

**I. Basha:** E gjithë procedura kalon përmes ligjit themeltar, ndërsa persa i përket vlerësimit të punedhënësve është vlerësuar me 4 shkallë: dobet, mjaftueshëm, mire, shumë mire. Masa disiplinore kur del mjaftueshëm, thirret drejtuesi dhe merret masa. Nëse nuk është dakort i drejtohet kryetari të basgkisë e me pas gjykatës.

**F. Cekrezi:** Neni 14 pika 1, domethënë në na kërkohet ta miratojmë por vetëm kryetari mund ta ndryshojë rregulloren, sben fare sens. Ankimimi është formal dhe monokratik.

**K. Cala:** Masa disiplinore jepet vetëm në një rast, kur nuk plotëson kuotën e votave, le të shkelen të gjitha pikat.

**A. Hasa:** Nëse ke ndonjë rast konkret hajde na e thuaj këtu, të mos e bëjmë politikë debatin.

**V. Bici:** Sa i përket rregullores ato që citoi Bardhi janë sakte, fuqinë e japim në si keshill smund të bëhet ankesa vetëm të kryetari.

**E. Shahini (Sek. Pergj):** Gjithmone ankesat i drejtohen titullarit, punedhënësit, ai ngre grupe ad hock që e merr në shqyrtim ankesën.

**E. Zani:** Përse nuk e përfshini këto që të në rregullore dhe pika tjetër përse e ndryshon vetëm kryetari?

**I. Basha:** Cdo ndryshim i rregullores do kalojë për miratim në keshill.

**L. Dollani:** Ky është vetëm një instrument vlerësimi, për mua është mjaft pozitive.

**T. Bici:** Diskutimi le të merret me thelbin e materialit, nëse ka ndonjë lapsus për të rregulluar, që nuk cenon thelbin e materialit le të ndryshohet.

**E. Zani:** E hedhim në votim por të bëhen plotësimet e rekomanduara?

\*Miratohet pika 3 e rendit të ditës me 11 Vota PRO

Nuk ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani

Greta Lena

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

Çështja 4  
(Pika 5 ne rend dite)

4- Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Kodrioni" SH.P.K., miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit"

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

**L.Zogu:** (citon bazen ligjore). Bashkia Gramsh ka marre nje nisme per krijimin e nje Shoqërie me Përgjegjasi te Kufizuara, me nje ortak te vetem, Kryetari i bashkise. Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin me nje afat te pacaktuar. (citon objektin e e veprimit te kesaj shoqërie, jane ne material). Kapitali fillestar 10000 leke, bashkelidhur eshte Statuti, nese keni pyetje?

**K.Cala:** Bashkia do te behet SHPK?

**L.Zogu:** Ligji na lejon qe ne te kemi mundesi te krijojme vete te ardhura, duke perdorur asetet tona.

**T.Bici:** Ligji nje te drejten per te krijuar nje shoqëri jo per tu shenderruar bashkia ne shoqëri shembull keni me ujesjellesin me pare. kushtet te imponojne te besh nje gje te tille. Shoqëria do te funksionojë me administrator dhe asamble me organe dhe nivele drejtimi si cdo shoqëri.

**F.Cekrezi:** Relacioni te ishte edhe me i qarte, te shohim impaktin qe do te jape kjo. Per krijimin e cdo shoqërie aksionare, hyn te planet strategjike, neni 156 i rregullores, duhet patjeter prezent Kryetari i Bashkise.

**G.Lena:** Eshte per tu pergezuar kjo nisme, eshte pergjegjesi dhe angazhim.

**V.Bici:** Ku do te veproje?

**L.Zogu:** Shfrytezim pyjesh, agroturizem, ndertimi i parqeve, fotovoltaiKET etj.. Fusha ne te cilat bashkia ka tagrin te veproje.

**T.Bici:** Fushat e veprimtarise se shoqërise jane te qarta, jane te rralla bashkite qe marrin nisma te tilla sepse eshte pergjegjesi e madhe.

**E.Zani:** Votojme?

\*Miratohet pika 4 e rendit te ditës me 11 Vota PRO

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani

Çështja 5  
(Pika 4 ne rend dite)

5- Për miratimin e "Udhëzuesit për Dhenien e Titujve Vendor të Nderit".

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

**E.Zani:** Sic u la porosi mbledhjen e kaluar kemi udhezuesin, per te cilin falenderoj grupin e punes.

**L.Dollani:** Prap kriteret me duken shume te pergjithshme.

**A.Hasa:** Titujt ti marrin ata qe jane personalitet, se kontribut te shquar mund te japi kushdo ne punen e tij.

**E.Shahini:** Fryma e ligjit ka kufizimet (kush propozon) dhe subjektivizmin. Mbledhja e dokumentacionit ka filtrat e vet, subjektivizmi dallohet kur ajo votohet, ndaj nuk ka nje tablele me pikezim. Ne paragrafin 5, ligji nuk e ndalon sa tituj jep, kjo eshte ne doren tuaj. Titulli me i larte jane titujt e vecante qe jep keshilli bashkaik, dhe te tilla mund te japi vec 2 sipas ligjit.

**F.Cekrezi:** Ky udhezues nuk ben dot kriter ekstra ato qe nuk njeh ligji, reference kemi ligjin e posacem per dhenien e titujve.

**E.Zani:** Them ta rishikojme edhe nje here, dhe e shohim muajn tjeter.

Sekretari Këshillit  
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani

Greta Lena

[Signature]

Ardiana Hasa

[Signature]

[Signature]

Çështja 6  
6- Kërkesa të qytetarëve ; Të tjera

Në mbledhje marrin pjesë 11 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Kodhel Cala, Marsela Ibro.

**E.Zani:** Ne pamundesi te mbledhjes se komisionit kete muaj, do te propozoja disa raste gjendja shendetsore e te cieve duket teper e renduar . Ne plotesim te kushteve dhe kriterëve qe kemi cituar ne vendimin e posacem per keto raste , propozoj ti japim ndihme financiare per kurim qytetareve: z.E.Hoxha, znj.B.Miraka, z.D.Sadiku , znj. E.Kllogjeri.  
**A.Hasa:** Patjetër nese eshte mundesia pse te mos i ndihmojme.

\*Miratohet pika 6 e rendit te ditës (Kerkesat e Qytetareve) me 11 Vota PRO  
Nuk Ka vota Kunder  
Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit  
Xhullia Gjini



Kryetari Këshillit  
Enis Zani



REPUBLIKË E KOSOVËS  
 BASHKIJA E GRAMSHIT  
 SHKOLLË "MIRAZI"

...ash, më 30/04/2026

LISTË PREZENÇE E MËSHTETARËVE BASHKIAK  
 Mbledhja e Rrumbës e Këshillit Bashkiak Nr. 10/2026

EMER MBIEMER	DATA	EMER MBIEMER	FIRMA
1- ENIS ZANI	30.04.2026	Enis Zani	[Signature]
2- VALBONA VERUNI			
3- LULIETA DOLLAN	30.04.2026	Luljeta Dollan	[Signature]
4- KODHEL ÇALA	30.04.2026	Kodhel Çala	[Signature]
5- GRETA LENA	30.04.2026	Greta Lena	[Signature]
6- VISARION BICI	30.04.2026	Visarion Bici	[Signature]
7- ARDIANA HAJA	30.04.2026	Ardiana Haja	[Signature]
8- ALKETA ECI			
9- RAMAZAN BEANO			
10- EDMOND DUM			
11- ERALE ÇARÇI			
12- IDRI KOKLA			
13- ERISA ZOGU			
14- KUTIM BRAHDE			
15- MARSELA IBRO	30.04.2026	Marsela Ibro	[Signature]
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	30.04.2026	Dalip Hazizaj	[Signature]
18- ARNILDA DAKA PE	30.04.2026	A Arnilda Ednan	[Signature]
19- BRUNILDA			
20- LLOLLI			
21- FATBARDH ÇEKREZI	30.04.2026	Fatbardh Çekrezi	[Signature]
22- BRUNILDA ÇEVOR	30.04.2026	Brunilda Çevor	[Signature]

SEKRETARI I KËSHILLIT  
 XHULLIA ÇANI

[Signature]